KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

REZULTATE NGA MONITORIMI I ZBATUAR PËR

# GJUHËN E URREJTJES

NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Fokus në 3 komuna pilot:
**Shtip, Manastir dhe Tetovë**

Periudha e njoftimit
**01.05.2020 - 31.08.2020**

# KONTEKSTI KOMBËTAR

Në këtë periudhë në nivel kombëtar është vënë re trend i zmadhuar i gjuhës së urrejtjes. Në platformën e internetit **www.govornaomraza.mk** janë regjistruar gjithsej 431 raportime, thuajse dy herë më shumë për këtë periudhë në krahasim me vitin 2019. Numri më i madh i raportimeve në muajin maj dhe qershor ishin në lidhje me situatën e pandemisë me virusin COVID-19, me zgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe masat e ndërmarra nga ana e Qeverisë. Ndërsa në muajt korrik dhe gusht numri më i madh i raportimeve ishin në lidhje me zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe negociatat për përbërjen e Qeverisë së re në Republikën e Maqedonisë së Veriut.




# GJUHA E URREJTJES NË MEDIAT SOCIALE PËR PERIUDHËN NGA DATA 1 MAJ DERI NË DATËN 31 GUSHT TË VITIT 2020

## SI BAZAT MË TË PËRFAQËSUARA PËR GJUHËN E URREJTJES VAZHDOJNË QË TË JENË:

**40%**
Përkatësia etnike

**22%**
Përkatësia politike

**19%**
Orientimi seksual

## PIKU I GJUHËS SË URREJTJES NË PERIUDHËN E KALUAR ËSHTË I LIDHUR ME DISA MOMENTE TË RËNDËSISHME SHOQËRORE - POLITIKE:

**25 maj**
Mbajtja e mbledhjes me rastin e festës fetare myslimane Ramazan Bajram

**17 qershor**
Vendim për datën e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare

**26 korrik**
Shpallja e rezultateve zyrtare me rastin e zgjedhjeve të mbajtura

**25 gusht**
Publikim të propozimit për përbërjen e qeverisë së re

# SHTIP

[MAJ 2020]

Gjatë muajit maj, në Qytetin Shtip, ndodhi thirrje publike nga ana e predikuesit fetar për luftë të shenjtë, të shkaktuar nga gjuha e urrejtjes paraprake ndaj Romëve dhe myslimanëve në rrjetet sociale që e ofendoi Allahun dhe besimin mysliman. Kjo ngjarje shkakton në vetvete mosmarrëveshje dhe padurim në bazë të përkatësisë etnike dhe fetare ndërmjet popullatës rome dhe popullatës maqedonase në qytetet Shtip, Veles dhe Koçani.

Duke u nisur që këtu, një numër më i madh njerëzish filluan të përhapin gjuhë urrejtjeje në rrjetet sociale ndaj Romëve, ndërsa predikuesit fetarë nga Veles dhe Koçani me atë rast në ditët e ardhshme organizojnë mbledhje protestuese.



# SHTIP

[MAJ 2020]

Në faqen Facebook “Nalet da se storite” më datën 7.5.2020 është publikuar fotografi nga mbledhja e besimtarëve në shpjegimin e së cilës qëndron teksti “Kafshët satanike severxhane filluan me sharjen e besimtarëve dhe kishës. Nëse vini re diçka të ngjashme na shkruani”. Teksti i publikimit inkurajon dhe ndez padurim dhe intolerancë, që në thelb paraqet gjuhë urrejtjeje në bazë etnike dhe në bazë të përkatësisë fetare.







Gjatë muajit maj, DAP DR Shtip publikoi vendim për zgjedhjen e kandidatit për punësim. Në faqen Facebook “Shtipski aktuellnosti” ishte publikuar fotografi me vendim në të cilën ishte përmendur koment se DAP Shtip nuk paska mundur të gjejë kuadër të përshtatshëm në Shtip dhe prandaj ka nevojë që të “importojë”. Në vijim të publikimit pasojnë publikime si: “ta gëzojmë shqiptarizimin” dhe komente të ngjashme me përmbajtje ofenduese që shkaktojnë gjuhën e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike.






Më datën 1.6.2020 në profilin – twitter "Thunder Strake" ishte publikuar fotografi me logo të modifikuar të partisë politike LSDM në të cilën në yll ishte inkorporuar emblema e UÇK-së. Në shpjegimin e fotografisë pason tekst me këtë përmbajtje: "Fushata vdis si shqiptar filloi" Publikimi i tillë në vete përmban gjuhën e urrejtjes dhe nxit gjuhën e urrejtjes dhe intolerancës.

## SHTIP

[QERSHOR 2020]




Më datën 7.6.2020 në profilin – twitter të ministrit të shëndetësisë, Venko Filipçe, ishte publikuar video me mesazhin për mbështetje të punëtorëve shëndetësorë në gjuhën shqipe. Në vijim të videos pasojë komente me gjuhën e urrejtjes që nxitin përçarje dhe padurim.

Më datën 24.6.2020 në profilin – twitter të Jordan Gruev ishte publikuar lajm nga medium në lidhje me kandidatin e BDI për kryeministër, Naser Ziberi. Fjala e përbuzur e përdorur në publikim "shiptari" nxit gjuhën e urrejtjes dhe padurim dhe intolerancë etnike.


Tweet

Jordan Gruev
@MAKEDONIKA1

Кандидатот за премиер на ДУИ ја почна кампањата со закана до Македонците - iNFOMAX.mk
infomax.mk/wp/кандидатот-...
Зибери и сите Шиптари треба да знаат дека само Македонците постојат на тапијата МАКЕДОНИЈА.
Translate Tweet



Кандидатот за премиер на ДУИ ја почна кампањата со закана до Македонци...
Насер Зибери е кандидатот на ДУИ за премиер на Македонија. Зибери, кој поли...ката ...иера ја почна ... ПДП, ...ри наврати беше пратеник, а ...
infomax.mk

3:16 PM · Jun 24, 2020 · Twitter Web App

# SHTIP

[QERSHOR 2020]

Në profilin - twitter , עַבְשִׁילְאֶ" më datën 4.6.2020 ishte publikuar koment në lidhje me orën policore të zbatuar në periudhën e festës fetare Ditën e shpirtrave, në të cilin ishte shprehur pakënaqësi. Janë përdorur fjalë përbuzëse si "shqiptari", "ciganë", "kaurë" që paraqesin gjuhë eksplicite urrejtjeje që është e përfaqësuar çdo ditë në shoqërinë tonë.


Tweet

אלישבע
@DmDrnJarinja7

Ние што се буниме за полицискиот. Немаме против, шиптари, цигани, каури.
Имаме против племиња, кои не почитуваат ништо.
Ваљда се разбираме.
Translate Tweet

6:26 AM · Jun 4, 2020 · Twitter for Android

24 Retweets 161 Likes

**SHTIP**

[KORRIK 2020]


МАКЕДОНИЈА

**Мултиетничка химна, задолжителен албански јазик и половина работен ден во петок – Зибери ја претстави програмата на ДУИ**

Објавено пред 3 ч
Од **Макфакс**

**Д Зоро**
@The_Zorro

Ова у Албанија да го бараш, кретену шиптарски

Translate Tweet

Në profilin - twitter „D Zorro" më datën 29.6.2020 ishte postuar publikim me fragmente nga titulli i lajmit nga media në lidhje me programin zgjedhor të BDI. Në publikim janë përdorur fjalët "kreten shqiptar" me të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë nxitet përçarje, padurim dhe urrejtje në bazë të përkatësisë etnike.

# SHTIP

[KORRIK 2020]

Gjatë muajit korrik në qendrën e qytetit Shtip, në muret e stadiumit të qytetit është vizatuar instalim artistik – mural me ngjyrat e ylberit si simbol i bashkësisë LGBTI. Lajmi është shpërndarë në faqen "Makedonski press" dhe në vijim të publikimit pasojnë komente me gjuhën e urrejtjes, padurimit dhe intolerancës ndaj bashkësisë LGBTI.

Makedonski.press

2 h · 

Денес градскиот стадион на Штип изгледа вака ...

Можеме повеќе, можеме уште подобро ❗❗



Slobodno se vkluci jas kje ve isklucam kje bide obelen dzido stip ne e pederski grad taa demonstracija na drugo mesto sekoj sho kje se pojave da crta kje go snajde zlo

41 m Like Reply 1

Крвта педерска 1

1 h Like Reply

# SHTIP

[KORRIK 2020]



што е воа педерското знаме или шарена револуција? Тука треба да стое нашето лого а не педерски знамиња!

2 m Like Reply




Të njëjtën natë pas vizatimit të muralit nga ana e grupit të panjohur të autorëve mbi mural është shkruar grafit me përmbajtjen “Pederastë vdisni nga sida”. Ky mbishkrim është fotografuar dhe është shpërndarë në Facebook nga ana e përdoruesit “Zak Makrol” i cili ndër të tjerash publikon se “urrej reklamim publik shoqëror të homoseksualizmit” prandaj vdisni nga SIDA, MENJËHERË!”. Ky koment është shprehje e fuqishme e gjuhës së urrejtjes dhe padurimit, që nxit edhe komente të tjera të ngjashme. Ngjarja vandale e shkatërrimit të muralit është filmuar në formë të video – materialit.



Zak Makrol

4 h

Зошто денот кога СДСМ има митинг во Штип, во паркот во 8ми Ноември (и се уништува зелената површина) на стадионот се родија боите на ХомоГејБиЛезбо лобито...? Извинете ама морав да го доукрасам логото на педерите баш овака. Мразам јавно, општествено прокламирање на хомосексуализам затоа умрете од СИДА, ОДМА !!!




Pas publikimit në twitter nga ana e profilit të Stojançe Angellov në lidhje me pjesëmarrjen e tij në emisionin politik pason koment i profilit me pseudonimin "Seriski Podjebavaç" me përmbajtje vulgare dhe ofenduese që janë shprehje e padurimit dhe urrejtjes nacionale, etnike, duke shprehur tallje dhe fyerje shumë të madhe ndaj Romëve dhe Shqiptarëve.

**SHTIP**

[KORRIK 2020]




Në rrjetin twitter nga ana e profilit "@MeXconiGlio" është shkruar tekst, i përkushtuar asaj që këngëtarja botërore Dua Lupa publikoi foto me kartën e Shqipërisë së madhe. Në komentet që pasojnë është shkruar tekst: "shiptari është shiptar" që shkakton intolerancë dhe padurim në bazë nacionale.

## SHTIP

[KORRIK 2020]

Në rrjetin – twitter nga ana e profilit "@Lacipapak" është publikuar tekst në lidhje me zgjedhjet e fundit parlamentare dhe sulmin haker në faqen e KSHZ në kohën e numërimit të votave. Në vetë tekstin përcaktohet se "Shiptari nuk ka tru të bëjë sulm haker me ndihmën e 10.000PC pa Kalanë!" Ai në vetvete përmban shprehjen e nënvleftësimit, padurimit ndaj bashkësisë shqiptare dhe paraqet gjuhë urrejtjeje.



# SHTIP

[GUSHT 2020]

**Аритмија**
@snowgirly2

Гледам родители се организираат на фејс, пишуваат петиции, предлози, дебатираат за наставата а таму некоја теткица во МОН си ги лакира ноктите и пцуе што мора да го земе кафето и да стане од столица за да испуши цигарче надвор.

Translate Tweet

7:51

**Домаќин Чоек од ///RepublicOf5G///**
@DomakjinChoek

Replying to @snowgirly2

Нема теткици у МОН. Све се млади накурчени шиптарки и шиптарчиња, ич не им чуе за ништо, Македонец нема ни за лек и тешко ќе чуеш Македонски таму.
А и да - не се лакираат, натокмени се уште од дома, се куцаат и после по молови и кафичи. А коа се таму - внатре си пушат.
Тоа...

Translate Tweet

Në profilin - twitter ,,@snowgirly2", më datën 7.8.2020, ishte publikuar koment në lidhje me organizimin dhe administrimin në MASH dhe punën e tyre. Në vijim të tweet-it pason koment me gjuhën e urrejtjes në të cilin shpjegohet se administrata është e përbërë vetëm nga persona të rinj për të cilët përdoret forma e gjuhës së urrejtjes "shiptarë" dhe "shiptarka".

Në deklaratën e liderit të Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, ai i thërret të gjithë Shqiptarët të bashkohen si në vitin 2001, sepse në qoftë se Maqedonsit ngritën flamurin e bardhë atëherë, do ta ngrenë edhe tani. Deklarata e tillë e politikanit Ali Ahmeti ka shkaktuar gjuhën e urrejtjes dhe është e shpërndarë nga profili twitter ,,@sweety_eyes_", ku si në vijim nxitet padurimi dhe mostoleranca sipas përkatësisë etnike.

**Плавоока** @sweety_eyes_ · Aug 13
Бре бре бре!
Да коментирам или да пцујам во себе?

ВЕСТИ

Ахмети -Повик до сите албанци да се обединиме како во 2001 -тогаш македонците кренаа бело знаме ќе

**Danger high power**
@Geko80640289

Replying to @sweety_eyes_

Абе шиптар племе ти ебам расипано да не беа педерите од нато и еу ти ке беше сега историја и сигурно ке бевте под 5% пошто ке имаше јако газење од специјалците моли бога шо се убаци и америка сорта расипана

Translate Tweet

## SHTIP

[GUSHT 2020]

Në profilin - twitter „@a_be__e_be" është publikuar tweet me përmbajtje ofenduese dhe me gjuhën e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, të frymëzuar nga postimi i publikuar paraprakisht i lidhur me tranzitimin e personave nga Kosova.







Në profilin - twitter „@Vesna221091663" është shpërndarë shaka që i tall përkatësit e bashkësisë LGBTI. Publikimi i tillë nxit padurim, mostolerancë dhe promovon diskriminim në bazë të orientimit seksual.

Në profilin - twitter „@Postarot" është publikuar shaka me përmbajtje që ofendon dhe nxit përbuzje dhe padurim ndaj përkatësve të bashkësisë rome.



# TETOVË

[MAJ 2020]




Në tetove në rrugën “Bllagoj Toska” në tunel që bashkon dy ndërtesa rezidenciale, janë shkruar dy grafitë, njëri me përmbajtjen “Vdekje për shiptarët” dhe tjetri me përmbajtjen “Shiptarë pidha”. Grafitet nxitin urrejtje në bazë të përkatësisë etnike.




Në faqen – facebook "Napred Teteks" është publikuar fotografi nga takimi i ministres së mbrojtjes Znj. Radmilla Shekerinska me ish anëtarin e UÇK-së ku në sfond shihen simbole dhe monumente të UÇK-së. Në vijim të publikimit pasojnë shumicë e komenteve negative, ndër të cilat edhe komente të Bojan Avramovski me përmbajtjen "Rrënjët e këtij satani janë shqiptarë" Ky koment dhe fotografia shkaktojnë përçarje, padurim etnik, fetar dhe kombëtar.

## TETOVË

[MAJ 2020]




Më datën 18.5.2020 personi Igor Gjorevski publikoi publikim personal në faqen e tij – facebook me përmbajtjen "Shiptari dhe cigani në shtëpi për bajram". Ky publikim paraqet shprehje të qartë të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike dhe fetare.

# TETOVË

[MAJ 2020]







Me rastin e vendosjes së gardhit prej betoni në rrugën: "Cvetan Dimov" në komunën Çair, në të cilën jeton popullatë dominuese shqiptare, personi Gjorgi Galetanovski në profilin e tij – facebook publikoi fotografi nga rruga "Cvetan Dimov". Kjo fotografi dhe publikim shkaktuan më shumë komente negative me gjuhën e urrejtjes ndaj qytetarëve shqiptare, që në bazë paraqesin përhapje të padurimit nacional dhe fetar.

# TETOVË

[KORRIK 2020]



Më datën 23.6.2020 në afërsi të Shkollës së mesme profesionale ekonomike “8-mi Septemvri – Tetovë” dhe para kopshtit të fëmijëve është vënë re grafit me përmbajtjen: “Pidha kaurësh” Ky grafit shkakton mosrespektim, intolerancë dhe padurim ndaj bashkësisë maqedonase që jeton në Tetovë dhe paraqet shprehje vulgare dhe gjuhë urrejtjeje.




Në faqen fan – facebook të Bashkimit të forcave të reja të VMRO DPMNE Tetovë, aktivistët partiakë kanë publikuar fotografi nga mbledhja partiake.
Në vijim të publikimit pason koment me përmbajtjen „ajde lëshoni edhe nga një lot... që fotografia të jetë komplete" koment ndaj të cilit është kthyer me fjalët: "Simona Ivanova do të lëshosh ti lot kur fëmijët e tu do të mësojnë shqiptarisht në iliridë, përveç nëse je nga ata të kundërtit dhe që nuk shqetësohesh shumë për trashëgimtarët".
Ky koment përmban gjuhë urrejtjeje në bazë të përkatësisë kombëtare dhe orientimit gjinor / seksual.

## TETOVË

[KoRRIK 2020]

Aktivit partiak i VMRO – DPMNE nga Tetova, Miroslav Simoski – Sheshka, i kritikon në mënyrë të ashpër aktivitetet e LSDM-së në kuadër të fushatës parazgjedhore, duke publikuar përmbajtje ofenduese në profilin e tij – facebook me fjalët: alooooooo mutra të prapambetur komunistësh paskeni bërë reklamë me atë qen kasapi të Syrizës si nuk keni turp". Ky publikimi është shprehje e intolerancës dhe padurimit të fuqishëm politik që në bazë të gjuhës së urrejtjes në bazë të përkatësisë politike.



# TETOVË

[KORRIK 2020]




Në rrjetin social Facebook është vënë re diskutim i ashpër ndërmjet qytetarëve Shqiptarë, që në komentet e tyre përhapin gjuhë urrejtjeje, padurim kombëtar dhe fetar ndaj të krishterëve dhe Maqedonaseve. Komentet janë me lëndime eksplicite dhe urrejtje e padurim.



# TETOVË

[GUSHT 2020]







Në tetove në rrugën "Bllagoj Toska" në tunel që bashkon dy ndërtesa rezidenciale, janë shkruar dy grafitë, njëri me përmbajtjen "Vdekje për shiptarët" dhe tjetri me përmbajtjen "Shiptarë pidha". Grafitet nxitin urrejtje në bazë të përkatësisë etnike.

# MANASTIR

[MAJ 2020]

Televizioni “Tera” në faqen e saj – facebook publikon lajm për ndërtimin e gardhit metalik që vendoset në unazën në Manastir. Në vijim të publikimit pasojnë komente me përmbajtje fyese që përmbajnë gjuhën e urrejtjes dhe padurimit ndaj përkatësve të bashkësisë Rome.









# MANASTIR

[MAJ 2020]




Në faqen – facebook të grupit "Bitollski problemi" më datën 17.5.2020 është publikuar lajm në lidhje me renovimin e vendpushimit të fëmijëve në Parkun kombëtar Pelister. Në vijim të publikimit nga përdorues të rrjetit social janë shkruar komente që paraqesin shprehje të fuqishme të padurimit dhe intolerancës ndaj përkatësve të partisë politike.




Televizioni "Tera" në faqen e tij – facebook, më datën 21.5.2020 , publikon lajm të lidhur me rinovimin e burgut të Manastirit. Komentet e lajmit përmbajnë gjuhë urrejtjeje ndaj Romëve, padurim, përbuzje dhe tallje.

# MANASTIR

[MAJ 2020]

Përdoruesi i rrjetit social Facebook në publikimin personal shpreh qëndrime që në vetvete përmbajnë gjuhë urrejtjeje në bazë të përkatësisë partiake, respektivisht politike dhe në bazë nacionale.






Në faqen – facebook të grupit "Bitollski problemi" më datën 17.5.2020 është publikuar lajm në lidhje me renovimin e vendpushimit të fëmijëve në Parkun kombëtar Pelister. Në vijim të publikimit nga përdorues të rrjetit social janë shkruar komente që paraqesin shprehje të fuqishme të padurimit dhe intolerancës ndaj përkatësve të partisë politike.

## MANASTIR

[QERSHOR 2020]

Në faqen – facebook të portalit "Edna e Makedonija" më datën 27.6.2020 ishte publikuar artikull në lidhje me Hitlerin dhe disa kuriozitete që njerëzit nuk i kanë ditur për të. Komentet në vijim mohojnë, minimizojnë dhe miratojnë gjenocid dhe krime lufte, gjithçka me qëllimin për nxitje të urrejtjes dhe dhunës ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual.






Nga ana e televizionit "Tera" nëpërmjet faqes së tyre – facebook më daëtn 18.6.2020 ishte publikuar artikull në lidhje me aktgjykimin penal kundër Boki 13 për rastin Reket. Në vijim të publikimit janë vënë re komente që përmbajnë gjuhë urrejtjeje ndaj personave me orientim të ndryshëm seksual dhe identitet të ndryshëm gjinor.

**MANASTIR**

[QERSHOR 2020]

Nga ana e televizionit "Tera" më datën 9.6.2020 dhe nga ana e faqes zyrtare të portalit të internetit "APLLA" ishte publikuar lajm për ndërtimin e unazës mbi qytetin e Manastirit dhe ai lajm ishte shpërndarë në faqet e tyre – facebook. Në komentet me rastin e publikimit ishte vënë re gjuhë ofenduese nëpërmjet të cilës përhapet urrejtje dhe padurim ndaj Romëve.



# MANASTIR

[QERSHOR 2020]

Në profilin -facebook të përdoruesit “Bitollski Ropak” ishte publikuar status me përmbajtje satirike, dhe në komente ishte vënë re gjuhë që nxit urrejtje dhe padurim.







# MANASTIR

[KORRIK 2020]



Në gjysmën e parë të muajit qershor në qendrën e Manastirit janë vënë re tre grafitë në dy lokacione të ndryshme. Ato paraqesin gjuhë eksplicite urrejtjeje në bazë të përkatësisë seksuale dhe gjinore, respektivisht orientimit seksual. Në fotografinë e parë vihet re kryqi i thyer i vizatuar mbi dy simbolet që paraqesin gjininë mashkullore. Në fotografinë e dytë gjithashtu vihet re kryq i thyer i vizatuar mbi dy simbolet që paraqesin gjininë femërore. Grafitet janë të vizatuara në objekte në rr. “Stiv Naumov” në Manastir. Në fotografinë e tretë mund të vihet re se si të dyja simbolet që paraqesin gjininë femërore janë të mbishkruara me shenjën “x” të vizatuara në rr. “Marshall Tito” në Manastir e njohur si “korzo” ose “shëtitore”.

# MANASTIR

[KORRIK 2020]



Më datën 2.7.2020 për hapjen e botimit të përvjetorit të 15-të të festivalit AKTO për art modern në fasadën e kinemasë “Partizan” në Manastir ishte mbishkruar mesazh “Të zinj, të bardhë, ezmerë, të verdhë, harrojini grindjet e vjetra. Sapo të filloni të bisedoni me njerëzit së bashku, të gjithë së shpejti do të jemi në marrëveshje” pjesë nga “Kënga për solidaritetin” e Bertold Brech. Për jo plot 24 orë, gjatë natës, me ngjyrë të zezë ishte shkruar mesazhi “Vdekje për Serbët!! + Vdekje për Shiptarët!!!”. Mesazhi në vetvete përhap gjuhë urrejtjeje dhe shkakton përçarje dhe padurim ndaj bashkëqytetarëve që janë nga përkatësie etnike serbe dhe shqiptare.

Link nga televizioni lokal “Tera”:
https://www.youtube.com/watch?v=l0xwmfglp4s&feature=emb_title




Gjatë fushatës parazgjedhore në muajin korrik për Zgjedhjet parlamentare – 2020, nga ana e personit nga Manastiri, është shpërndarë publikim me fotografi dhe tekst për bartësin e listës në Njësinë zgjedhore 1, Nikolla Dimitrov. Publikimi është me përmbajtje ofenduese homofobike dhe e poshtëron bashkësinë LGBTI dhe shkakton komente plotësuese me gjuhën e urrejtjes ndaj përkatësve të LGBTI.

Gjatë muajit qershor, nga ana e përdoruesit të rrjetit social Facebook, që jeton në Manastir, është vënë re publikim që në bazë është shqetësim i personit privat, megjithatë vetë publikimi përmban gjuhë urrejtjeje në bazë të përkatësisë nacionale, fyerje dhe poshtërim të popullit bullgar.




## MANASTIR

[KORRIK 2020]

# MANASTIR

[KORRIK 2020]

Më datën 24 korrik në rrjetin social Tik – tok është publikuar video nga përdorues me ermin "qendrim_aliu" ku digjet flamuri shtetëror i RMV. Ky veprim paraqet akt të dukshëm të gjuhës së urrejtjes dhe si e tillë është e parashikuar si vepër penale në pajtueshmëri me Kodin Penal.



# MANASTIR

[GUSHT 2020]




Në grupin – facebook "Bitollski problemi" ishte shpërndarë publikim i një video nga zjarri në mjedisin rrethues në Manastir. Në vijim të publikimit pasojnë komente që paraqesin gjuhën e urrejtës ndaj përkatëseve të bashkësisë rome në Manastir.






# MANASTIR

[GUSHT 2020]

Në profilin – facebook të Tv "Tera" – Manastir, në lidhje me publikimin që përsëritet në tre muajt e fundit me temën "Ndërtimi i murrit mbrojtës" është vënë re gjuha e vazhdueshme e urrejtjes mbi përkatësinë etnike / ngjyrën e lëkurës të drejtuara ndaj Romëve. Romët gjithë kohën janë paraqitur si vjedhës, të pacivilizuar, fis i egër etj.









ГОВОР НА ОМРАЗА

FOUNDATION OPEN SOCIETY MACEDONIA
ФОНДАЦИЈА ОТВОРЕНО ОПШТЕСТВО МАКЕДОНИЈА

KOMITETI I HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Projekti është i financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni.
Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e përdoruesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni.